

HYLLI I DRITËS

Ubi Spiritus Domini, ibi libertas:
(II. ad Cor. III. 17).

VOTER
KULTURE
SHQYPTARE

9-10

Shtatuer-Tetuer 1941-XIX.

VJETI XVII.

S H K O D E R

Pajtimi per të perkohshmen „HYLLI I DRITËS“

Shqyptari	Nji numer	Fr. 1.00	Nji vjetë	Fr. 10.—
Itali	» »	» 1.00	» »	» 10.—
Nder vende tjera	» »	» 1.40	» »	» 14.—

DREJTUER E ADMINISTRUES : A. BENEDIKT DEMA

PERMBAJTJA

N. N. — Shkrimtarët e Shqyptaris	FAQE 365
A. BERNARDIN PALAJ e A. RROK GURASHI —	
Rrethë Kishës s' Abatit e Fisit të Shalës	370
P. BERNARDIN PALAJ — Kah nata e vetme	379
Dr. INJAC GJ. NDOJAJ — Fauna ihtiologjike e Li-	
qenit të Shkodrës	398
GELASIUS — Fjalori Toponomastik	410
BARDHYLI — Lushnja dhe Fshatrat per rreth sajë	418
D. ALEKSANDER SIRDANI — Frazheologji	422
SPIRO KONDA — Apologjija e Sokratit	425
P. DONAT KURTI — Kangë trimnije	434
P. ANTON HARAPI — Valë mbí valë	444
Kundrime Botnore	450
Dr. KOLË PRËLA — Kundrime Letrare	453
P. D. KURTI — Prralla. — Blë. II. Fash. 7.	



HYLLI I DRITËS

E PERKOHSHME KULTURALE-LETRARE

Shkrimtarët e Shqypnis.

Që do shkrimtari t' onë, të jetë i vogël a i madh, do t' i rrahë zembra sá herë qi të ndiej se flitet mbi shkrimtarët shqyptarë. Æsht një ligshiti, një nevojë të thuesh psychologjike për hartistin — e njimentë a të vetmbajtur — qi herë mbas here të përmendet e të lavdohet. Ky instikt femnuer, me dashtë me u ndie e me u kënaqë tue ndie lavde shpesh edhe prej gojëve të padëja, nder né ká marrë përpjestime morboze.

N' asnjë vend nuk do të jenë shkrimtarët aq të prekëshem nga fjalët e tjerëvet sa këtu te na, e këta duket se rrjedhë nga shkaku se në Shqypni mungon kritika. Pse mungon kritika serjoze këjo nuk është një punë e madhe; por shka deperton má teper zembren e njëj shkrimtari është se rrall e kurr nuk naltohen zâne unanime qi të prapojn si njëri të madh e të zotin njatë qi zyrtarisht njëfjet si i tillë. Megjithëkta kritika të veçuese qi të kën një frymë paksá individuale nuk pranohen. Me hî e me lavdue e me vû gojë pak a shumë me arsye mbi një shkrimtar të Shqypnis, doemos ka me u çue kush e me thanë se nuk ké folë objektivisht e se ké kënë i rrëmbyem nga pasjoni etj; madjë është bá modë nder né, tash sá vjetë me rradhë, me folë për një kritikë objektive qi do të ndriçojë shtigjet e letersis. Æsht vështirë me kuptue se kû duen me dalë gjith ata të rij e pleq kur thonë se kemi nevojë të ngutëshme për një kritikë objektive e është vështirë me u kuptue si mund të na dalë kritikë e vertetë e



